


Fjalat e Paqes



Maria, nëna e tij,
pasi u fejua me Jozefin,
para se të banonin së bashku,
u gjet shtatzënë
për virtyt të Shpirtit Shenjt.
(Mt 1,18)

Lajmëtar fetaro-kulturor i Arqipeshkvisë Metropolitane Shkodër - Pult Nr. 6 (131) Viti XVIII Tetor - Nëntor 2016

MARTIRËT SHPALLEN TË LUMË



DOM ERNEST SIMONI - TROSHANI
ME DATË 19-20 NËNTOR 2016
PAPA FRANÇESKU E BËN
KARDINAL
TË KISHËS KATOLIKE ROMAKE



LITTERAE APOSTOLICAE

Nos,
vota Fratris Nostri
Angeli Massafra, O.F.M.,
Archiepiscopi Metropolitae Scodrensis-Pulatisensis,
necnon plurimorum aliorum Fratrum in Episcopatu
multorumque christifidelium explentes,
de Congregationis de Causis Sanctorum consulto,
auctoritate Nostra Apostolica
facultatem facimus ut
Venerabiles Servi Dei
Vincentius Prennushi, ex Ordine Fratrum Minorum,
Archiepiscopus Dyrracenus, et XXXVII Socii,
martyres Ecclesiae in Albania,
qui tenebroso persecutionis tempore
heroico animo fidei lumen accensum servarunt,
Beatorum nomine in posterum appellentur,
eorumque festum
die quinta mensis Novembris
in locis et modis iure statutis
quotannis celebrari possit.
In nomine Patris et Filii et Spiritus Sancti.
Amen.

Datum Romae, apud Sanctum Petrum,
die primo mensis Novembris, in sollemnitate Omnium Sanctorum,
anno Domini bismillesimo sexto decimo,
Pontificatus Nostri quarto.

Franciscus



LUMNIMI I 38 MARTIRËVE

KRONIKA

Kisha Katolike ka 38 të Lumë të rinj, të shkruar në Regjistër më 5 nëntor 2016 në Shkodër, Shqipëri. Këta 38 Martirë të shekullit XX në Shqipëri janë vrarë në odium fidei nën diktaturën komuniste të Enver Hoxhës.

Prej ditës së 26 prillit 2016, kur Papa Françesku firmosi Dekretin e Lumnimit, Komisioni i formuar nga Konferenca Ipeshkvnore Shqiptare, ka punuar që kremtimi solemn dhe historik t'ia dilte mbanë në mënyrën më të mirë: falënderohen të gjithë anëtarët.

Kremtimi solemn i Lumnimit është zhvilluar më 5 nëntor 2016 në Katedralen e Shkodrës, dhe është drejtuar nga Prefekti i Kongregatës për Kauzat e Shenjtërve, Hirësia e Tij Kardinali Angelo Amato, të cilit i janë bashkuar zotërinjtë Kardinalë Angelo Bagnasco, Rainer Maria Woelki, Salvatore De Giorgi, e Crescenzo Sepe, i cili hapi Sesionin e parë Publik më 10 nëntor 2002.

Arqipeshkvij dhe Ipeshkvij të shumtë kanë bashkëkremtuar. Nga'Italia: Diego Causoro (Delegat Apostolik), Salvatore Ligorio (Potenza), Beniamino De Palma (Nola), Andrea Bruno (Udine), Michele Seccia (Teramo), Oscar Cantoni (Crema), Vincenzo Pisanello (Oria), Francesco Cacucci (Bari), Giorgio Demetrio Gallaro (Epark greko-katolik i Piana degli Albanesi), Donato Oliverio (Epark greko-katolik i Lungro-s); nga Hungaria: András Veres; nga Sllovenia: Andrej Glavan; nga Lituania: Rimantas Norvila; nga Kroacia: Mate Uzinić (Dubrovnik), Antun Škvorčević (Pozega), Zelmir Puljic (Zadar); nga Bosnia: Tomo Vuksic (Sarajevë), Pero Sudar (Sarajevë); nga Mali i Zi: Ilija Janjic (Kotorr), Rrok Gjonlleshaj (Tivar), Zef Gashi (ipeshkëv i nderuar i Tivarit); nga Ukraina: Milan Shashik (Epark greko-Katolik); nga Kosova: Dodë Gjergji; Nunci Apostolik i nderuar Ramiro Moliner Ingles.

Mbi prezbiter ishin të pranishëm edhe përfaqësuesit e shumë Dioqezave dhe Familjeve rregulltare: Mons. Duarte da Cunha (CCEE), Don Michel Remery (CCEE), Mons. Leonardo Di Mauro (Konf. Ip. Italiane), Mons. Gianfranco Mascher (Vikar i përgjithshëm Brescia), Don Carlo Tartari (Brescia), Don Giuseppe Rossi (Brescia), Mons. Filippo Salvo (Trani), Mons. Lino d'Onofrio (Vikar i përgj. Nola), Arqimandriti Antonino Paratore (Piana degli Albanesi), Don Nicollo Galetti (Këln), Mons. Helmut Moll (Këln), Ministri ynë Gjeneral, Fr. Michael Perry e Zëvendës Postulatori i Përgjithshëm Fr. Luis Martin Rodriguez, Gjenerali i Salvatorianëve P. Milton Zonta, Delegati Gjeneral i Jezuitëve P. Giangiacomo Rotelli, Provinciali i Jezuitëve P. Gianfranco Matarazzo, Ministri provincial i Kapuçinëve të Puljes

Fr.Alfredo Marchello.

E plotësojnë numrin e këtyre të pranishmëve dhe bëjnë “nderimet e shtëpisë” Arqipeshkvi i Shkodër-Pultit dhe Kryetari i Konf. Ip. Shqiptare Imz. Angelo Massafra O.F.M., Imz. Ottavio Vitale (Lezhë), Imz. George Frendo (Administrator Dioqezan i Tiranë-Durrësit), Imz. Cristoforo Palmieri (Rrëshen), Imz. Hil Kabashi (Administrator Apostolik i Jugut), Don Simon Kulli (Administrator Dioqezan i Sapës), i Ngarkuari me Punë i Nunciaturës Apostolike në Tiranë Imz. Romano Mbena, Kardinali i porsazgjedhur, Don. Ernest Simoni (Troshani), Vikari i përgjithshëm i Dioqezës, Don Nikolin Toma, Famullitari i Katedrales Don Artur Jaku, që ka lexuar në shqip për besimtarët Homelinë e Kardinalit, Zëvendës Postulatori për Kauzën e Martirëve, Fr. Vincenzo Focà O.F.M. që ka drejtuar Ceremoninë liturgjike.



Kisha Katedrale është zënë në pjesën më të madhe nga meshtarë bashkëkremtues në numër rreth 330 të ardhur nga anë të ndryshme dhe nga rreth 500 murgesha, më të rejtat e të cilave janë treguar të gatshme për të qëndruar jashtë së bashku me besimtarë të shumtë shqiptarë, kroatë, kosovarë dhe italianë që kanë marrë pjesë në kremtim nga sheshi i Katedrales dhe nga rruga ngjitur me të, ajo e cila qe përshkuar nga shumë prej Martirëve të çuar për pushkatim pranë Varrezave katolike të Rremajt që gjenden aty afër.

Kanë nderuar me praninë e tyre edhe përfaqësuesit e Kishës Ortodokse Shqiptare, që kanë gjetur një vend nderi në prezbiter, Përfaqësuesi i Ungjillorëve dhe Kryetari i Bashkësisë Bektashiane; gjithashtu Presidenti i Republikës dhe Kryetari i Parlamentit të Shqipërisë, disa Autoritete nga Kosova; disa Ministra, Deputetë dhe Përfaqësues të Trupit Diplomatik në Shqipëri.

Në fund, një vend nderi u është caktuar në Katedrale disa të afërmve të Martirëve dhe, në mënyrë të veçantë, disa të moshuarve që i kanë njohur drejtëpërdrejt Martirët tanë në burgje dhe i kanë ndihmuar në çastet më të trishtueshme të dëshmisë së tyre të fesë.

Pas kërkesës së ritit drejtuar Kardinalit nga ana e Postulatorit të Përgjithshëm të Fretërve Minorë, Fr. Giovanni Giuseppe Califano, që ka ndjekur Kauzën e Lumnimit dhe të Arqipeshkvit Imz. Angelo Massafra, Kardinali Amato ka lexuar Dekretin me firmë të Atit të Shenjtë Françeskut e, me këngën e “ChristusVincit”, është zbuluar Figura në pëlthurë e Lumnimit që mban firmën e piktorit shqiptar Edmond Papathimiu, kopja e të cilit në stil akualet vepër e kolegut të tij Igli Arapi u është shpërndarë më pas besimtarëve me lutjen për Kanonizimin e vënë në anën e prapme të saj, të hartuar nga Arqipeshkvi Massafra.

Kremtimi, i thjeshtë dhe solemn njëkohësisht, është gjallëruar nga Kori liturgjik i Qytetit, i drejtur nga Maestrot Zef Çoba dhe Luka

Vijon në fq. 3

KONFERENCA IPESHKVORE E SHQIPËRISË KOMUNIKATË PËR SHTYP

”Nderi që iu bë sot me datë 19 Nëntor 2016, dom Ernest Toshanit u shkon të gjithë atyre që janë përndjekur padrejtesisht”: tha Imzot Angelo Massafra.

Kryetar i Konferencës Ipeshkvore dhe Arqipeshkëv i Arqidioqezës Shkodër - Pult, në emër të gjithë Kishës Katolike në Shqipëri falënderon Papën, i cili sot në Vatikan ka krijuar, midis të tjerëve, edhe një kardinal shqiptar: Dom Ernest Simoni - Troshanin. Një falënderim i takon vetë dom Ernestit për besnikërinë e tij ndaj Krishtit dhe ndaj Kishës. Ky nder na detyron të gjithë neve që të jetojmë në gjurmet e martirëve tanë të lumë

duke dashur Hyjin dhe Atdheun. Jetë të gjatë i urojmë kardinalit të ri.

Para dy ditësh kemi marrë edhe lajmin e bukur të emërimit të Arqipeshkvit Metropolit të Tiranë-Durrësit, Imzot Gjergj Frendos. Edhe atij në emër të gjithë ipeshkëvinjve dhe besimtarëve i urojmë këtë emërim. Falëminderit Papës që i ka dhënë një bari kësaj Arqidioqeze dhe i urojmë bariut të ri çdo të mirë në Zotin Jezus. Që ai të mund të jetë një bari sipas Zemrës së Krishtit.

Zëdhënësi për shtyp

LUMNIMI I 38 MARTIRËVE

Vijim i fq. 2

Mllugja që kanë ekzekutuar, përveç Himnit të Martirëve të kompozuar për rastin nga Maestro Çoba, “Missa De Angelis” dhe këngë të tjera shumë të njohura nga populli për të nxitur pjesëmarrjen aktive të besimtarëve në liturgji.

Kardinali Amato në Homelinë e tij, pasi ka kontekstualizuar Kremtimin e Lumnimit duke e vënë atë në lidhje me ngjarjen tjetër të hirit për Kishën shqiptare, atë të Kanonizimit të Shenjtes Nënë Tereza e Kalkutës, ka vënë në dukje se si dëshmia e Martirëve tanë ka qenë para së gjithash dëshmi e pranisë së Hyjit, me gjithë vuajtjet e stërmëdha që kanë pësuar. Pastaj duke cituar fjalën e atit të shenjtë Françeskut në vizitën e tij në Shqipëri të shtatorit 2014, ka kujtuar se përvoja e Martirëve duhet t'i ndihmojë katolikët për të “kujtuar dhe falur”, duke trashëguar prej tyre qëndrime dashurie, vëllazërie dhe harmonie.

Arqipeshkvi Angelo Massafra në fjalën e tij përmbyllëse ka shprehur para së gjithash ndjenjat e tij të mallëngjimit duke parë se si prej Shqipërisë së vogël edhe një herë Krishti është dëshmuar përpara botës, të vogëlsisë përpara këtyre gjigantëve të fesë që janë Martirët e shekullit XX në Shqipëri dhe të gatishmërisë për të vazhduar, si Kishë katolike e kësaj toke, në veprën e shpalljes dhe të dëshmisë së Krishtit të ringjallur. Më pas ka falënderuar në personin e kardinalit Amato, Papa Françeskun për dhuratat e lumnimit dhe të emërimit të Kardinalit të ri Ernest Simoni Troshani, të gjithë të pranishmit, ata që kanë bashkëpunuar në çfarëdo cilësie për organizimin e ngjarjes dhe në mënyrë të veçantë Postulacionin e përgjithshëm të Fretërve Minorë dhe Shtetin shqiptar që ka njohur publikisht dhe zyrtarisht pafajësinë juridike të Martirëve tanë.

Në fund, ndërmjetësisë së tyre dhe asaj të Shenjtes Terezë të Kalkutës, ia ka besuar urimin për të pasur të gjithë një zemër të re, të vëmendshme ndaj nevojave të ngutshme të shoqërisë dhe bujare për të bërë të mirën e përbashkët, por edhe të mirën për Kishën universale dhe shpëtimin e mbarë botës.

“Rroftë Krishti Mbret! Rroftë Shqipëria!”, fjalët e fundit të Martirëve, tash më në fund të Lumë, kanë qenë edhe fjalët e fundit të Arqipeshkvit dhe të të gjithë Kremtimit. Për lavd të Krishtit. Amen.

Fr. Luigi Aluisi O.F.M.

KËRKESË PËR LUMNIMIN

Në fillimin e Meshës Postulatori Atë Gianni Califano dhe Imzot Angelo Massafra, Arqipeshkvi, kanë bërë kërkesën, që vijon, për Lumnimin e 38 Martirëve tanë, Kardinalit Angelo Amato:

Është me mallëngjim të thellë dhe përkujtim mirënjohës që Kisha e Shqipërisë bën të kumbojnë në këtë asamble liturgjike



emrat e 38 Shërbëtorëve të nderuar të Hyjit kandidatë për lumnim.

Martirizmi i tyre u krye mes viteve 1945 dhe 1974 në kontekstin e përndjekjes së dhimbshme dhe të zgjatur të kryer në këtë komb fisnik nga armiq të Kishës katolike, në urrejtje të fesë.

Në gjysmën e dytë të shekullit XX° Shqipëria hyri në rrugën për t'u bërë njëri nga Shtetet më kundërshtare të përvojës fetare të njeriut, në veçanti të fesë së krishterë. Në

vitin 1967 u shpall Shteti i parë ateist i botës. Përndjekja u bë kundër çdo tipologjie dhe klase të besimtarëve, klerit, rregulltarëve dhe laikëve, të rinjve dhe të moshuarve, të shtresave të ndryshme shoqërore dhe kulturore. Shumë u vranë mizorisht, u poshtëruan me gjyqe të rreme publike, të akuzuar për komplete të trilluara, me qëllimin për ta zhdukur krejtësisht nga kombi Emrin Tejet të shenjtë të Hyjit.

Në këtë radhë të gjerë viktimash, shndrisin 38 Shërbëtorë të nderuar të Hyjit: dy Ipeshkvij, njëzet e një Meshtarë Dioqezanë, shtatë Fretër Minorë, tre Jezuitë, katër Laikë dhe një Seminarist.

Ndër ta, i pari që ra viktimë e urrejtjes së fesë qe Don Lazër Shantoja, meshtar i Arqidioqezës Shkodër-Pult, i pushkatuar në Tiranë më 5 mars 1945.

I dyti qe Don Ndre Zadeja, meshtar i Arqidioqezës Shkodër-Pult, i pushkatuar në Shkodër më 25 mars 1945.

Pasoi grupi i gjashtë Shërbëtorëve të Hyjit të dënuar me pushkatim në Shkodër më 4 mars 1946: Atë Giovanni Fausti, meshtar me kushte të përjetshme i Shoqërisë së Jezusit,

Rektor i Seminarit Papnor Shqiptar në Shkodër; Atë Daniel Dajani, edhe ai meshtar jezuit; Atë Gjon Shllaku, meshtar me kushte të përjetshme i Urdhrit të Fretërve Minorë; Mark Çuni, seminarist; Gjelo Shllaku, laik, më i ri i grupit, 21 vjeç; Qerim Sadiku, laik i martuar, me profesion tregtar.

Fill më pas dhanë jetën për Krishtin:

Don Alfons Tracki, meshtar i Arqidioqezës Shkodër-Pult, i pushkatuar në Shkodër më 18 korrik 1946;

Frano Mirakaj, laik baba i familjes, fshatar, i pushkatuar në shtator të vitit 1946 në Shkodër;


Don Jozef Marxen, meshtar i Arqidioqezës së Durrësit, i pushkatuar më 16 nëntor 1946 në Tiranë;

Atë Bernardin Palaj, meshtar i Urdhrit të Fretërve Minorë, i vdekur në burg në Shkodër nga keqtrajtimet e pësuar, më 2 dhjetor 1946;

Vijon në fq. 4

LUMNIMI I 38 MARTIRËVE

Vijim i fq. 3



në Lezhë më 11 maj 1947;

Fratel Gjon Pantalja, rregulltar me kushte të përjetshme i Shoqërisë së Jezusit, i vdekur për shkak të torturave më 31 tetor 1947 në Shkodër;

Don Mark Xhani (Gjani), meshtar i Arqidioqezës Shkodër-Pult, i vdekur nën tortura në Shpal në vitin 1947;

Don Anton Zogaj, meshtar i Arqidioqezës Tiranë-Durrës, i pushkatuar më 9 mars 1948 në Durrës.

Më 11 mars 1948 u pushkatuan në Shkodër tre Shërbëtorë të Hyjit: Mons. Frano Gjini, Ipeshkëv dhe abat nullius i Shën Llezhdrit (Aleksandrit) të Oroshit në Mirditë, zëvendës i Delegatit Apostolik; bashkë me Të dy Fretër Minorë, meshtarë, Atë Çiprian Nika dhe Atë Mati Prendushi.

Shërbëtorët e tjerë të Hyjit të vranë në vitet që pasuan qenë:

Don Dedë Plani, meshtar i Arqidioqezës Shkodër-Pult, i vdekur më 30 prill 1948 në Shkodër nën tortura;

Don Ejëll Deda, meshtar i Arqidioqezës Shkodër-Pult, i vdekur më 12 maj 1948 në Shkodër si pasojë e vuajtjeve të burgut;

Don Anton Muzaj, meshtar i Arqidioqezës Shkodër-Pult, i vdekur për shkak të torturave në pranverën e vitit 1948 në Shkodër;

Don Pjetër Çuni, meshtar i Arqidioqezës Shkodër-Pult, i vdekur në Koplik më 31 korrik 1948 nën tortura;

Don Lek (Aleksandër) Sirdani, meshtar i Arqidioqezës

Don Luigj Prendushi, meshtar i Dioqezës së Sapës, i pushkatuar më 24 janar 1947 në Shkodër;

Don Dedë Maçaj, meshtar i Arqidioqezës Shkodër-Pult, i pushkatuar më 28 mars 1947 në Përmet;

Atë Serafin Koda, meshtar i Urdhrit të Fretërve Minorë, i vdekur për shkak të torturave

Shkodër-Pult, i vdekur më 26 dhjetor 1948, i mbytur në gropën e zezë në burgun e Koplikut (Shkodër);

Atë Josif Papamihali, meshtar i Ritit greko-katolik shqiptar, i vdekur më 26 tetor 1948 në Maliq, gjatë vuajtjes së dënimit me punë të detyrueshme;

Mons. Vinçenc Prennushi, Arqipeshkëv i Durrësit, Primat i Shqipërisë, i Urdhrit të Fretërve Minorë, i vdekur më 19 mars 1949 në burgun e Durrësit nga keqtrajtimet e pësuar;

Don Jak Bushati, meshtar i Arqidioqezës Shkodër-Pult, i vdekur për shkak të torturave më 12 shtator 1949 në Lezhë;

Atë Gaspër Suma, meshtar i Urdhrit të Fretërve Minorë, i vdekur më 16 prill 1950 në Shkodër nga torturat e pësuar dhe pa mjekime;

Marije Tuci, laike, e vetmja femër e grupit, kandidate për jetën rregulltare në Institutin e Motrave Françeskane Stigmatine, e vdekur më 24 tetor 1950 në Shkodër nga torturat e pësuar;

Atë Jul Bonati, meshtar i Arqidioqezës Tiranë-Durrës, më i moshuari i grupit 77 vjeç, i vdekur më 5 nëntor 1951 në Durrës nga vuajtjet e burgut;



Atë Karl Serreqi, meshtar i Urdhrit të Fretërve Minorë, i vdekur më 4 prill 1954 në Burrel nga keqtrajtimet e pësuar dhe pa mjekime;

Don Ndoc Suma, meshtar i Arqidioqezës Shkodër-Pult, famullitar, i vdekur më 22 prill 1958 në Pistull nga vuajtjet e pësuar në burg;

Don Dedë Malaj, meshtar i Arqidioqezës Shkodër-Pult, i pushkatuar më 12 maj 1959 në Breg të Liqenit; e Don Marin Shkurti, meshtar i Arqidioqezës Shkodër-Pult, i pushkatuar në muajin prill të vitit 1969 në Dajç;

Don Shtjefën Kurti, meshtar i Arqidioqezës Tiranë-Durrës, i pushkatuar më 20 tetor 1971 në Gurëz;

Don Mikel Beltoja, meshtar i Arqidioqezës Shkodër-Pult, i lindur në vitin 1935, i pushkatuar më 10 shkurt 1974 në Shkodër.

Të gjithë Shërbëtorët e Hyjit e pranuan në mënyrë shembullore dënimin e tyre të padrejtë: pranuan çdo vuajtje me shpirt durimi, qëndrese dhe besimi të vërtetë. Në çastin e vdekjes patën në gojë fjalët e faljes për persekutorët dhe ia besuan Zotit, vetveten dhe atdheun e vuajtur.

Me lirinë e rigjetur, të nesërmen e provës së dhimbshme, Kisha e Shqipërisë ndjeu nevojën për të ruajtur kujtimin e dëshmitarëve heroikë të fesë. Prandaj me dashuri dhe devotshmëri mbledhi provat e martirizimit të tyre gjatë Hetimit Dioqezan të Shkodrës të kryer në vitet 2002-2010. Më 26 prill 2016, festa liturgjike e së Lumes Virgjër Mari Nëna e Këshillit të Mirë, Pajtorja e Shkodrës dhe e Shqipërisë, Ati i Shenjtë Françesku

Vijon në fq. 5



LUMNIMI I 38 MARTIRËVE

Vijim i fq. 4



ka autorizuar shpalljen e Dekretit lidhur me martirizimin e 38 Shërbëtorëve të Hyjit, duke ia hapur rrugën lumnimit të sotëm.

HOMELIA E KARDINAL ANGELO AMATO

1. Është një ditë feste sot për shqiptarët e pranishëm jo vetëm këtu në Shkodër por edhe në shumë qytete të tjera në Shqipëri dhe jashtë saj. Vetëm dy muaj pas shenjtërimit të Nënë Terezës së Kalkutës, bijë e madhe e tokës suaj dhe grua heroike, pasqyrë e zemrës së mëshirshme të Hyjit dhe afër zemrës së brengosur të çdo qenieje njerëzore nevojtare për ndihmë e ngushëllim, lumnimi i 38 Martirëve shqiptarë u kujton të gjithëve se në tokë e mira pengohet vazhdimisht prej së keqes. Megjithatë, nuk janë përndjekësit, por martirët protagonistët e vërtetë të historisë së njerëzimit.

Ndërsa përndjekësit shpërbëhen si shumë hije të zeza, që humbasin përgjithmonë në errësirën e një harrimi të amshuar, martirët janë flakëza drite që shkëlqejnë në qiellin e njerëzimit, duke u treguar të gjithëve fytyrën njëmend të mirë të njeriut, identitetin e tij të thellë të qenies shëmbëlltyrë tejet e ngjashme me Hyjin.

Megjithëse në ferrin e një përndjekjeje arbitrare dhe të padrejtë, martirët tuaj kanë dëftuar para armiqve të tyre të njëjtat ndjenja dhe qëndrime të Krishtit: falje, besnikëri, qëndresë, vëllazëri, mëshirë. Në këtë mënyrë bëhen busulla e dobishme për orientimin tonë të duhur drejt limanit të së mirës, që është mbretëria e Hyjit që duhet ndërtuar edhe në këtë tokë.

Martirët janë dëshmitarët e atij njerëzimi të ri, që mbjell në histori jo luftëra, përçarje e vrasje të qenieve të pafajshme, por paqe, gëzim e vëllazëri, duke lartësuar talentet e njëmendta të qenies njerëzore të krijuar – siç thotë poeti Dante – «jo për të jetuar si shtazë por për të ndjekur virtytin dhe njohjen».

2. Liturgjia e Fjalës na jep tri faza të luftës së amshuar që armiku i Hyjit bën në tokë. Leximi i parë, i marrë prej Librit të parë të Makabejve, flet për popullin e Hyjit, të mposhtur e të poshtëruar prej mbretit Antiok,

pushtuesit blasfem, që ndalon flijimet e Tempullit, u lartëson altare dhe tempuj idhujve paganë, djeg librat e ligjit dhe vret gratë e fëmijët. Në këtë stuhi nuk mungojnë heronjtë që i kundërvihen shkatërrimit të kultit ndaj Hyjit të vërtetë. Shkrimi i Shenjtë thotë: «Megjithëkëtë, një shumicë në Izrael qenë të guximshëm e qëndroi e fortë e nuk hëngri ushqime të papastërta: më parë zgjodhën vdekjen se të ndoten me ushqime të papastërta e ta prishin Besëlidhjen e shenjtë» (1Mak 1,62-63).

Në Ungjill Jezusi i nxit apostujt që të jenë të fortë dhe të guximshëm, kur të dorëzohen në gjyqe dhe të urrehen nga të gjithë për shkak të emrit të tij: «Mos i druani – thotë Zotëria – ata që vrasin trupin e nuk mund ta vrasin shpirtin. Kini frikë më tepër nga Ai, që mund t'jua humbë në ferr shpirtin edhe trupin» (Mt 10,28).

Shpërblimi i besnikërisë ndaj Zotit ilustruhet në librin e Zbulesës, që flet për lavdërimin e atyre që vijnë prej mundimit të madh dhe që i kanë larë veshjet e tyre, duke i bërë të pastra me gjakun e Qengjit. Është shumica tejet e madhe e martirëve të çdo kombi, fisi, populli e gjuhe, që të mbështjellë në veshje të bardha dhe me degë palme në duar qëndrojnë pranë fronit të Hyjit. Këta «Më kurrë s'do të kenë uri, më kurrë s'do të kenë etje, më s'do t'i djegë dielli as rrezet e tij. Sepse Qengji që është në mes të fronit do t'i kullosë dhe do t'i çojë në burimet e ujërave të jetës. Edhe Hyji do të fshijë çdo lot nga sytë e tyre» (krh. Zb 7,9-17).

3. Mundimi, martirizimi, lavdërimi. Ky është fati që u ka takuar martirëve shqiptarë. Vuajtjet e tyre paraqesin një faqe tragjike të historisë europiane. Nga njëra anë përndjekësit mizorë, nga ana tjetër martirët e pambrojtur.

Shumë vetë në atë stuhi poshtërimi dhe gjaku pyesnin se ku ishte Hyji. Por qenë vetë martirët ata që u përgjigjën se Zoti ishte me ta, i mbështeste në vuajtje, ngjitej në Kalvar me ta, pësonte me ta, qante me ta. Në martirët shqiptarë Jezu Krishti rijetonte mundimet e veta dhe vdekjen e vet. Jezusi ishte pranë Dom Lazër Shantojës kur u pushkatua në Tiranë më 5 mars 1945 dhe pranë Dom Ndre Zadejës kur u pushkatua në Shkodër më 25 mars 1945. Në të njëjtën mënyrë, më 4 mars 1946, në orën e pushkatimit, Jezusi ngushëllonte jezuitët Giovanni Fausti e Daniel Dajani,

françeskanin Gjon Shllaku, seminaristin Mark Çuni, të riun njëzet e një vjeçar Gjelosh Lulashi dhe babain e familjes Qerim Sadiku.

Veçanërisht mizore qe, për shembull, vrasja e Imzot Frano Gjinit, që prej ipeshkvijve katolikë ishte ngarkuar të dialogonte me regjimin në pushtet. Imzot Gjini u arrestua, u akuzua për propagandë anti-komuniste, u torturua dhe pësoi urinë e etjen deri në sfilatje. I varur në një pemë në oborrin e Sigurimit, u rrah dhe u hodh në ujërat e zeza. Në fund u ekzekutua më 8 mars 1948 së bashku me 18 vetë të tjerë, meshtarë dhe laikë. Ky guxim mbinjerëzor ishte fryt i hirit të Krishtit që e mbështeste martirin në vuajtjet çnjerëzore të torturave.

Edhe martirët e tjerë – mes të cilëve arqipeshkvi i Durrësit, imzot Vinçenc Prennushi – të

Vijon në fq. 6



LUMNIMI I 38 MARTIRËVE

Vijim i fq. 5



procesuar, të dënuar megjithëse ishin të pafajshëm, të torturuar dhe të vrarë, e ndienin praninë e Krishtit pranë tyre. Prej hirit të tij ata merrnin forcën për ta përballuar me kthjelltësi si dhe me gëzim provën e martirizimit. E dinin se do të bashkëndanin ringjalljen e Krishtit dhe se gjaku i tyre do të ishte fara për pranverën e Kishës në Shqipëri.

4. Falë Provanisë Hyjnore, pema e Kryqit, e rrahur prej stuhisë komuniste, sot ka lulëzuar përsëri me një energji të përtërirë në Shqipëri, sipas shembullit të Krishtit, të kryqëzuar dhe të ringjallur. Kisha – duke kujtuar fjalën e Jezusit: «Nëse mua më salvuan, edhe ju do t'ju salvojnë» (Gjn 15,18-20) – pas shtypjes ka rilindur edhe më e shkëlqyeshme se më parë, e forcuar edhe prej dëshmisë së bijve të vet martirë.

E dimë se feja nuk kishte vdekur kurrë në Shqipëri. Kur mungonin meshtarët, qenë prindërit ata që pagëzuan fëmijët, i mësuan në fe, bekuan martesat. Thënia e lutjeve dhe e rruzares qe përforcuar. Vizitoheshin muzetë vetëm për të soditur kryqet dhe figurat e shenjta. Shpesh njerëzit shkonin në kishat e braktisura për t'u lutur. Kremtoheshin fshehurazi të kremtet e Krishtlindjeve dhe të Pashkëve. Pavarësisht prej ndalesës së prerë për të përdorur emra të krishterë, fëmijët shpesh në shkollë tregonin emrin shekullar dhe në shtëpi atë të pagëzimit. Lexoheshin fshehurazi Bibla dhe librat fetarë.

Pasi kaloi stuhia, më në fund dielli i lirisë shkëlqeu përsëri mbi popullin tuaj të fortë dhe guximtar. Kur mjegulla e terrorit u shpërbë në vitin 1990 njerëzit filluan t'i uronin përsëri njëri-tjetrit duke buzëqeshur: “Gëzuar Pashkët”. U mbyllën përfundimisht muzetë e ateizmit në Tiranë dhe në Shkodër. Dhe më 4 nëntor të vitit 1990 u kremtua një meshë në kapelën e varrezave të Shkodrës me pjesëmarrjen e rreth 50.000 besimtarëve. Më 25 prill 1993 Gjon Pali II bekoj gurin e parë të shenjtërores së Zojës së Këshillit të Mirë, pajtores së Shqipërisë. Kisha shqiptare, me ipeshkvijtë e vet, meshtarët dhe besimtarët, është si një lis shekullor, që nuk lejon të shkulet prej erërave e prej stuhive të stuhisë, por mbetet i rrënjësor fort në fenë në Krishtin.

5. Po si duhet reaguari përballë mujsharive të një diktature çnjerëzore e gjakatare? Le të kujtojmë e le t'i bëjmë tonat fjalët e Papa Françeskut: «Mos i harroni plagët, por mos u hakmerrni. Ecni përpara duke punuar me shpresë për një të ardhme të madhe».

Përballë genocidit fetar të diktaturës komuniste të shekullit të kaluar qëndrimi i katolikëve është ai që të kujtojnë dhe të falin. Kujtimi shërben për të përforcuar ftesën e Jezusit që t'i falim armiqtë, madje edhe t'i duam e të lutemi për përndjekësit. Prej martirëve katolikët duhet të trashëgojnë jo qëndrime urrejtjeje, inati dhe përçarjeje, por ndjenja dashurie, vëllazërie e harmonie. Sot katolikët, duke kujtuar bijtë e tyre martirë, duhet t'i mbështjellin me mantelin e faljes ata që i kanë përndjekur, keqtrajtuar dhe vrarë. Kjo është dhurata që Kisha katolike i bën me gëzim dhe bindje popullit shqiptar, që të jetojë me shpirt të pajtuar

bashkëjetesën me vëllezërit.

Pas disa ditës Papa Françesku do të krijojë kardinal Dom Ernest Simonin (Troshan), meshtar i Arqidioqezës së Shkodrës, të mbijetuar të përndjekjes. Fjalët e tij të para kanë qenë: «Kjo dhuratë e Atit të Shenjtë është për mua një nxitje e mëtejshme për t'u bërë mjet i shpëtimit të shpirtave, në emër të tij. Vetëm në Krishtin gjendet shpëtimi dhe sot bota ka më shumë se kurrë nevojë për këtë lajm».

Shqipëria, vendi i shqipeve, përveç Gjergj Kastriotit Skënderbeut (1405-1468), të quajtur Athleta Christi nga papa Kalisti III, ka në Nënë Terezën e Kalkutës dhe në Të Lumët Martirë të shekullit të kaluar edhe heronj të tjerë të lavdishëm të fesë e të atdheut, që përhapin në botë emrin e mirë të popullit shqiptar.

Të Lumët Martirë, lutuni për ne.

PËRSHËNDETJA E IMZOT ANGELO MASSAFRA

Eminencat shumë të Nderuara,
Bashkëvëllezër në Episkopat,
Imzot Romanus Mbena, i ngarkuar me Punët e Nunciaturës,
Imzot Asti, i deleguari i Kishës Ortodokse
Eprorë Gjeneralë dhe Provincialë,
Meshtarë e të Kushtuar Zotit,
Autoritete Shtetërore të Kosovës dhe të Shqipërisë,
Autoritete Diplomatieke, Deputetë dhe Autoritete Civile,
Hirësia e Tij Edmond Brahimaj, Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve,


Te nderuar familjarë të Martirëve,

Besimtarë që keni ardhur këtu nga çdo anë për të kremtuar këtë ngjarje kaq të dëshiruar të Lumnimit të Imzot Prennushit dhe Shokëve Martirë, është dëshirë e imja e madhe, në përfundim të këtij bashkëkremtimi solemn, të shpreh ndjenjat e zemrës sime në këtë moment.

Para së gjithash, dëshiroj të bashkëndaj emocionin e thellë që ndiej duke parë se sot, prej Shqipërisë së vogël, në të gjithë Kishën dhe para gjithë botës, Krishti edhe një herë është dëshmuar prej forcës së paarmatosur të martirizimit. Martirët tanë i shtohen asaj liste gjithmonë të hapur burrash e grash që, me jetën e tyre, i kanë dhënë lavdi Hyjit dhe kanë ushqyer fenë e guximin e popullit të krishterë në çdo kohë dhe në çdo vend.

Provoj një ndjenjë vogëlsie përpara këtyre gjigandëve të fesë dhe, në të njëjtën kohë, ndiej se Zoti thërret ende në një gatishmëri të madhe, për ta shpallur e kumtuar si të Ringjallur e të Gjallë; i fton dhe u prin me dashuri të gjithë burrave e grave që të pajtohen me Atin dhe, kështu, të

Vijon në fq. 6



LUMNIMI I 38 MARTIRËVE

Vijim i fq. 6

jetojnë një jetë të re, të lirë nga çdo kompromis me të keqen. E kuptoj edhe se kjo gatishmëri që na kërkon sot Zoti nuk mund të dhurohet ndryshe përveçse duke bërë sakrifica të vogla apo të mëdha dhe, në këtë kuptim, është një thirrje në martirizim edhe për ne, jo më të përndjekur nga ideologji shprehimisht kundërshtare të fesë, por nga forma ideologjike më tinëzare dhe të rrezikshme që gjithashtu na nënshtrojnë dhe duan të na largojnë prej Hyjit.

Dëshiroj të bekoj e të falënderoj Zotin për të gjitha këto dhe, së bashku me ju, të kërkoj forcën e Shpirtit Shenjt për këtë Kishë të vogël në tokën e Shqipërisë. Jemi një pjesë e vogël, por me zemër të madhe dhe, prandaj, të gatshme për atë që Zoti do të kërkojë prej nesh.

Nuk kam fjalë të mjaftueshme që të shpreh mirënjohjen time personale dhe atë të të gjithë Episkopatit shqiptar ndaj Atit të Shenjtë për këtë dhuratë tejet të madhe të Lumnimit.

Eminencë, disa herë në letrat e fundit e kemi shprehur këtë falënderim; ju lutemi që, edhe një herë, Ju të bëheni zëdhënës i ndjenjave tona më të thella të vlerësimit e të mirënjohjes për gjithë dashurinë që, në shumë forma, Papa Françesku është duke dëftuar ndaj Kishës sonë dhe popullit shqiptar, jo e fundit dhurata e një Kardinali në personin e don Ernest Simonit (Troshanit).

Endiej si detyrë të falënderoj edhe të gjithë ata që kanë ndihmuar që të arrihej në këtë ditë: ata që nuk janë më mes nesh, por prej qiellit sot na bëjnë shoqëri (mendimi shkon në mënyrë të veçantë tek i paharrueshmi Atë Leonardo Di Pinto OFM), dhe ata që janë të pranishëm e që, me çfarëdo titulli, kanë punuar apo janë duke punuar për lavdinë e Hyjit dhe nderimin e duhur ndaj Martirëve tanë. Po i lejoj vetes vetëm të citoj në mënyrë të veçantë Postulacionin gjeneral të Fretërve Minorë, Atë Gianni Califano dhe Zëvendës Postulator Fra Vinçenc Foca që ka shoqëruar dhe ndjekur çdo itinerar të nevojshëm që nga fillimi e deri më sot dhe të gjithë anëtarët e Gjyqit për Çështjen e Martirëve.

Një falënderim që vjen prej zemrës do të doja t'ia drejtoj Parlamentit të Republikës i cili me anën e një rezolute solemne këto ditë dënoi fuqishëm vrasjet dhe persekutimin e regjimit komunist dhe njohu me bindje të plotë pafajsinë e martirëve tanë.

Faleminderit, faleminderit nga zemra të gjithëve. Dhe faleminderit Juve Hirësi që keni dashur të jeni këtu me ne në këtë ditë feste për të bashkëndarë gëzimin tonë dhe, përsëri, për të mbjellur shpresë në zemrat tona: vërtet kemi shumë nevojë për këtë! Ecja nuk ka përfunduar,



por sapo kemi filluar dhe kemi shumë nevojë të ndiejmë dashurinë amënore të Kishës universale që na shoqëron dhe na nxit në rrugëtimin tonë të bashkimit të përditshëm me Krishtin Mësues e Zot.

Faleminderit të gjithëve ju, zotërinj Kardinalë, Kardinalit tonë Dom Ernest Simonit (Troshani), juve Ipeshkvij që keni ardhur nga Kisha të ndryshme, të gjithëve ju Meshtarë, Rregulltarë e Rregulltare.

Falënderoj Juve Autoritetet Shtetërore të Kosovës dhe të Shqipërisë që na keni nderuar me praninë tuaj.



Falënderoj Përfaqësuesit e Kishave motra me të cilët bashkëndajmë të njëjtën fe trinitare dhe falënderoj Përfaqësuesit e Besimeve të tjera me të cilët ecim së bashku me vetëdijen se i japim nderim të vetmit Hyj.

Një falënderim të përzemërt dëshiroj t'ia drejtoj Kryetares së Bashkisë dhe bashkëpunëtorëve të saj për ndihmën që na kanë dhënë në organizimin dhe mbarëvajtjen e kësaj ngjarjeje historike.

Jam i lumtur që sot këtu afër altarit janë ulur në këto karrige burra dhe

gra që u shërbyen martirëve nëpër burxhe e kampe përqendrimi. Duam sot duke ju pasur perpara t'ju falënderojmë ju e në ju të gjithë ata që si Simon Cireneu e Veronika lehtesuat vuajtjet e martirëve me guximin e besnikërinë tuaj. Ata u lutshin për ju. Faleminderit edhe Policisë që është kujdesur për rendin dhe sigurinë publike. Gjithashtu, falënderoj ata që kanë bashkëpunuar në përgatitjen e këtij kremtimi solemn, në veçanti të gjithë Anëtarët e Komisionit, Famullitarin e Katedrales, korin, vullnetarët dhe personelin mjeko-shëndetësor.

Një aspekt jo i parëndësishëm, pa të cilin nuk do të kishim mundur ta jetonim këtë ditë dhe që meriton një falënderim të veçantë është ai i mbështetjes ekonomike për të cilën falënderoj me gjithë zemër të gjithë ata që kanë dhënë ndihmesën e tyre, sidomos falënderoj Kryeministrin.

Faleminderit edhe punëtorëve të Mediave: vëmendja juaj ndaj kësaj ngjarjeje ndihmon që Martirët tanë dhe Shqipëria jonë edhe një herë të kenë jehonë botërore; në veçanti falënderoj TVSH-në për transmetimin e drejtpërdrejtë.

Së fundi, ndiej për detyrë të falënderoj publikisht dy artistët që kanë realizuar pikturat prej të cilave janë nxjerrë në pelhurën e madhe të Lumnimit dhe në figurat e shenjta me lutjen që do të na lejojë të kërkojmë përsëri prej Zotit hirin e Shenjtërimit të Martirëve tanë: Z. Edmond Papathimiu dhe Z. Igli Harapi. Dhe pas falënderimeve të duhura, më lejoni edhe që të shpreh dy urime të singerta.

Para së gjithash urimi që në çdo anë të botës, ku përkatësia e ndryshme fetare përdoret për të shfajësuar krime të vërteta kundër njerëzimit, të reshtë dhuna dhe përndjekja kundër atyre që nuk bashkëndajnë të njëjtin këndvështrim fetar të jetës.

Pastaj, duke shikuar periudhën historike që jemi duke kaluar, në të cilën tokat tona të Shqipërisë dhe Kosovës janë të angazhuara për t'u bërë ballë vështirësive të mëdha me natyrë ekonomike, shoqërore e morale, uroj që gjaku i derdhur prej Martirëve tanë të bëhet me të vërtetë për ne “farë” e një jete të re. Shembulli i tyre na dhashtë guximin dhe forcën për të qenë të gjithë të angazhuar, secili sipas kompetencave dhe përgjegjësi të veta kishtare, shoqërore apo politike, për të ndihmuar më të dobëtit e shoqërisë, për të zhdukur varfërinë, për t'u dhënë punë e dinjitet të gjithë personave dhe për të ndihmuar kështu në të mirën e të gjithëve.

Ndërmjetësimi i tyre, së bashku me atë të Shenjtes Nënë Tereza, pranë fronit të Hyjit të mëshirshëm fitoftë për ne një zemër të re, të vëmendshme ndaj nevojave të ngutshme të shoqërisë sonë, dhe bujare për të realizuar të mirën e përbashkët. Ata fitofshin për ne prej Mirësisë hyjnore të mirën për Kishën e gjithëmbarshme dhe shpëtimin për gjithë botën. Së bashku me Martirët tane, sot dëshiroj të ripohoj me forcë: “Rroftë Krishti Mbret! Rroftë Shqipëria!”.

LUMNIMI I 38 MARTIRËVE



Me 9 nëntor 2016 Presidenti i Republikës, Sh. T. Z. Bujar Nishani vlerësoi me një ceremoni solemne 38 Martirët e Kishës Katolike shqiptare, të cilët u lumnuan pak ditë më parë nga Ati i Shenjtë, Papa Françesku. Në fjalën e Tij para të ftuarve sonte në Pallatin e Brigadave ku ishin të pranishëm autoritetet më të larta të shtetit, Kryetari i Kuvendit Ilir Meta, Kryetari i Opozitës, Lulzim Basha, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, familjarët e 38 Martirëve, Ambasadorë dhe përfaqësues të Trupit Diplomatik të akredituar në vendin tonë, klerikë dhe drejtues të Kishës Katolike shqiptare, përfaqësues të bashkësitëve fetare, etj., Para se t'i jepte këtyre Martirëve **Dekoratën e lartë të “Flamurit Kombëtar”**, Kreu i Shtetit Shqiptar: Presidenti Nishani tha këtë fjalim të vecantë që vijon:

FJALIMI I PRESIDENTIT

“Kisha Katolike dhe klerikët e saj të rrënjosur në këtë tokë prej dhjetëra shekujsh janë kudo në indet e këtij kombi qysh në ngjizjen e tij. Historia e këtij institucioni milenar në Shqipëri është sa histori ngadhnjimi, po aq edhe martirizimi, sa histori besimi, po aq edhe patriotizmi, sa histori fetare, aq edhe kulture, sa histori meshe, po aq edhe histori shkrimi, sa histori katolicizmi, aq edhe harmonie e bashkëjetese, sa histori shqiptare, po aq edhe evropiane e universale. Ajo është një trashëgimi e lavdishme e Shqipërisë, një realitet i vyer i saj.

Koha, ngjarjet, pushtimet, ideologjitë nuk e kanë kursyer së vëni në provë të rëndë, në provë ekzistence me mjetet e dhunës antike e ato të tiranisë moderne. Kjo Kishë, rregulltarët dhe besimtarët e saj nuk kanë zhgënjyer kurrë. Ata e kanë shprehur shumë herë të vërteten e tyre me martirizim duke ndezur dritën e Zotit, atë të gjuhës dhe kulturës shqiptare, të vetë idesë kombëtare sa herë ajo shuhej, duke mos iu frikur vdekjes aq sa ofronin jetën e tyre si dëshminë më të epërme të shpirtit dhe lirisë.

Nga Pal Engjëlli i Skënderbeut deri tek Hirësia e Tij Kardinal Ernest Troshani, lista është e gjatë, e gdhendur librave, mungadave, kuvendeve, betejave për pavarësi dhe shtetformim, hetuesive, gjyqeve dhe ployës së Komunizmit, por mbi të gjitha në vetë kujtesën e kombit mbi të cilën mbahet thagma shqiptare. E thënë me fjalët e Atë Gjergj Fishtës ajo rri si përmendore që nuk e dërrmon as rrufeja e as moti. Tridhjetë e tetë të kësaj liste, të cilët gjithë jetën kishin jetuar dhe ushtruar vokacionin e tyre brenda formulës së shenjtë 'Atdhe e fe' teksa ndaheshin nga jeta tokësore pyesnin 'Çfarë duhej të bënim më tepër për të qenë shqiptarë?!' Pasi kishin qëndruar heroikisht përballë torturave dhe vendimit që i denonte me vdekje, iknin këso bote në sintoni me mësimet e shenjta duke falur ekzekutorët e tyre duke lënë mbi dhë amanetin e fundit 'Rrnoftë Shqipëria edhe pa ne'. Nuk është e lehtë t'i përkufizosh e t'i ndash veç e veç, por mund të themi se ishin klerikë e intelektualë, mendimtarë e shkrimtarë të shquar të këtij vendi, pjesëmarrës vendimtarë në të gjitha ngjarjet e rëndësishme të Shqipërisë duke filluar me Rilindjen Kombëtare, për të vazhduar me konsolidimin e shtetit të pavarur pas vitit 1912 dhe institucioneve akademike e pedagogjike. Duhet thënë se brenda këtij grupimi rri edhe redaksia e revistës 'Hylli i Dritës'.

Ata qysh në vitet '30-të paralajmëruan rrezikun që do të sillte bolshevizmi në Shqipëri. Po, të parët u përballen me hakmarrjen e tij duke krijuar modelin e qëndresës, të përballjes dhe të triumfit të njeriut të lirë ndaj tiranisë ideologjike që i kishte shpallur luftë Zotit dhe bijve të tij. Shkuan të vetëdijshëm drejt martirizimit, drejt qiellit. Me gjakun e tyre u shkrua himni i lirisë dhe demokracisë shqiptare. Papa Françesku, ky mik i

madh i vendit tonë i shpalli ata të lumë duke i bërë pjesë së historisë së përbotshme e duke emancipuar kësaj qëndrimin tonë mbi historinë kombëtare, duke na ftuar të ndahemi nga dogmat totalitare, duke na ftuar të refuzojmë versionet ideologjike që tentojnë të relativizojnë krimet makabre të diktaturës. Ata s'kanë nevojë për asgjë. Ndërgjegjia jonë ka nevojë për ta. Kjo ndërgjegje ka nevojë të kërkojë falje, ka nevojë të identifikohet me ta, ka nevojë t'i nderojë ata, ka nevojë t'u rrëfejë fëmijëve për ta, ka nevojë t'i përcjellë nga e ardhmja brez pas brezi.

Të dashur bashkëqytetarë!

Pranimi me përunjësi i krimeve, jo i gabimeve, siç mund t'i quajë ndokush me dinakëri apo mendjelehtësi – dhe këtë e theksoj fort duke ju shikuar të gjithëve në sy, – të regjimit komunist, pendesa e vërtetë dhe kokëulur, por mbi të gjitha, kërkesa e sinqertë për falje, drejtuar para të gjithëve familjarëve të viktimave të pafajshme për ato krime që janë kryer në 'emër të popullit', na ndihmon të gjithë si shoqëri shqiptare të shtrëngojmë radhët vëllazërisht e të ecim përpara pa pasur kurrë më frikë nga fantazmat e së kaluarës së errët diktatoriale.

Prandaj, në cilësinë e Kryetarit të Shtetit e ndiej të domosdoshme, sepse në radhë të parë ma kërkon ndërgjegjia ime si qytetar, që me shumë përunjësi, t'u kërkoj një falje të sinqertë, në emër të shtetit që më ka zgjedhur të shërbej e të jem me devotshmëri simboli i unitetit të popullit: familjarëve dhe pasardhësve të viktimave të panumërta të diktaturës komuniste, edhe atyre që ende nuk u janë gjetur as eshtrat, t'i kërkoj falje edhe Kishës Katolike shqiptare, por edhe kujdo tjetër, që u prek deri në palcë nga djepi e deri në varr, që u vra pafajësisht, u përdoq deri në tri breza, u internua padrejtësisht, që u dëmtua fizikisht, materialisht, por më tepër shpirtërisht, që u cenua rëndë në dinjitetin e vet njerëzor dhe që u privua nga të drejtat thelbësore dhe universale të njeriut, dhe që ndoshta vazhdon ende sot e kësaj dite të vuajë pasojat e tmerrshme e gati-gati të pariparueshme të atyre krimeve makabre, të cilave iu vesh përsipër padrejtësisht petku se po kryheshin në emër të shtetit dhe të ashquajturës 'luftë klasash'!

Shteti shqiptar sot, ju kërkon sinqerisht dhe përunjësisht: Ndjesë!**Ju kërkon falje dhe ju shpreh pendesë!****Të nderuar të pranishëm!**

Sonte nga kjo sallë historike le t'i shqiptojmë emrat e tyre një nga një duke u përkulur me mirënjohje të thellë e përunjësi para kujtimit të tyre: Imzot Vinçenc Prennushi, OFM; Imzot Frano Gjini; Imzot Jul Bonati; Atë Mati Prendushi, OFM; Atë Serafin Koda, OFM; Atë Karl Serreqi, OFM; Atë Gjon Shllaku, OFM; Atë Gaspër Sumës, OFM; Atë Çiprian Nikaj, OFM; Atë Giovanni Fausti, SJ; Atë Bernardin Palaj, OFM; Atë Daniel Dajani, SJ; Dom Alfons Tracki; Dom Anton Muzaj; Dom Anton Zogaj; Dom Dedë Malaj; Dom Dedë Plani; Dom Dedë Maçaj; Dom Ejëll Deda; Dom Jak Bushati; Dom Lazër Shantoja; Dom Lekë Sirdani; Dom Luigj Prendushi; Dom Mark Xhani; Dom Mikel Beltoja; Dom Ndre Zadeja; Dom Pjetër Çuni; Dom Shtjefën Kurti; Dom Marin Shkurti; Dom Ndoc Suma; Dom Josef Markseni; Dom Josif Papamihali; Vëlla Gjon Pantalialia, SJ; Marije Nikollë Tuci; Fran Mirakaj; Gjelo Lulashi; Mark Çuni; Qerim Sadiku.

Të dashur miq,

Sonte jemi mbledhur në këtë ceremoni disi të vonuar solemne jo për t'u dhënë 38 Martirëve të Kishës Katolike dhe të popullit shqiptar, atë çfarë u takon. Ata janë vetëdekoruar në altarin e sacrificës sublime. Në fakt lavdia e tyre s'ka nevojë për asgjë teksa dinjiteti ynë dhe standardet etike kanë nevojë për të. Më shoqëron një brengë teksa komunikoj me ju, sepse edhe në këtë moment që flasim shteti shqiptar nuk ka gjetur ende udhën të shfuqizohen të gjitha aktet e fajësisë politike me, të cilat gjykonte padrejtësia e diktaturës dhe t'i shpallë ata të pafajshëm.



Vijon në fq. 9

LUMNIMI I 38 MARTIRËVE

Vijim i fq. 8

Sigurisht tejet më të lehtësuar e ballëlartë do të ndihemi nëse një proces sa moral e aq gjyqësor do të funksionojë për të gjykuar xhelatët e tyre si një tentim për të rikthyer të drejtën mes nesh. Fatkeqësisht sado të çmeritur, shumë prej nesh jemi dëshmitarë të rikthimit të nostalgjive enveriste dhe të krenarisë kriminale për figurat e regjimit që u përmbys në vitin 1990.

Paradoksalisht vjet ndodhi më e padëshirueshmja gjë. U vlerësuan me medalje shumë prej veglave më kriminale të diktaturës, njëri prej tyre ishte edhe hetuesi i At Zef Pllumit dhe Sami Repishtit. Deri këtu s'duhej të arrinim! Dukuria e estetizmit të krimit me emra tingëllues si 'bunk art' apo 'shtëpi me gjethe' po shndërrohet në një tendencë preokupuese ndërkohe që asnjë burg famëkeq apo kamp internimi nuk është pjesë e planeve muzeale të kujtesës. Tendenca e shndërrimit të historisë në legjendë popullore ka për qëllim manipulimin dhe relativizmin e krimit. Martirët mund të na falin shumëçka, por nuk do të na e falin kurrë harresën dhe fshehjen e së keqes, së cilës iu kundërvunë me çmimin e jetës. Në vend të banaliteteve të realizmit socialist fëmijët tanë duhet të nxënë librat e tyre të dijes e të memories. Ata duhet të zënë vend në kurrikulat shkollore.

Dua të flas hapur me ju! Presidenti i Republikës nuk disponon asnjë mundësi ligjore veç aktit të faljes kur në fakt shpresojmë që ata që u martirizuan të na falin ne, dhe jo e kundërta. Ndaj propozoj sonte që Parlamenti shqiptar të hartojë një ligj të posaçëm për Gjykatën Speciale, duke ngarkuar Ministrinë e Drejtësisë, të iniciojë procesin e vonuar, por të domosdoshëm të rigjykit me kërkesë dhënien e pafajësisë duke fillur me 38 Martirët si një masë e domosdoshme si dallim esencial të lirisë nga tirania, si reflektim i shoqërisë mbi të mirën dhe të keqen, si ndarje e saj me të kaluarën duke shëruar plagët e saj. Le të ushtrojmë për këtë qëllim të shenjtë çdo të drejtë qytetare që na jep Kushtetuta e vendit.

Të nderuar klerikë, të nderuar ambasadorë, të nderuar që pranishëm!

Ndihem i privilegjuar që më takoi mua si President i Republikës që t'i atashoj kujtimit të 38 Martirëve më të lartin Urdhër shtetëror, atë të Flamurit Kombëtar, për të cilin ata dhanë jetën. Ata pyesnin çfarë duhet të bëjmë më tepër për të qenë shqiptarë? Ne iu themi sonte çfarë duhet të bëjmë më tepër për t'ju merituar, për të marrë faljen dhe bekimin tuaj? Falë burrave si ju, iu drejtohem pikërisht Martirve se besoj në jetën e tyre të përtejme, mund të përsërisim moton: 'Ti Shqipëri na jep nder, na jep emrin shqiptar.'

Ju qoftë e lehtë lëndina nën hijen e Flamurit Kombëtar!

Ju faleminderit!"

PERSHENDETJA E IMZOT ANGELO MASSAFRA PAS DHËNJES SË ÇMIMEVE FAMILJARËVE TË MARTIRËVE

Shkelqësi e Nderuar, President Nishani!
Të dashur familjarë të martirëve të Lumë!
Të nderuara Autoritete Shtetërore dhe Fetare!
Të nderuar përfaqësues të Selive Diplomatieke dhe Deputetë,

Zoti President, faleminderit për këtë ditë të bukur dhe historike!

Do të ishte logjike që këtë përshëndetje të shkurtër ta filloja me fjalët “e kush do ta kishte menduar disa kohë më parë se do të ishim në këtë pallat duke dekoruar Martirët që diktatura komuniste i vrau veç pse besonin në Jezu Krishtin!”. Kjo logjikë që sapo thashë ka në vetvete një farë fataliteti pasi fsheh disi mendimin se vdekja edhe mund të ketë pushtet përgjithmonë.

Martirët tanë janë martirë që vdiqën duke dëshmuar jetën dhe dashurinë e Zotit për jetën e gjithë njerëzimit. Ata besonin në Zotin dhe vdiqën duke dëshmuar e duke flijuar vetveten. Sot ngadhënjëjnë me Zotin. Janë të Lumë sepse u rrënjosën në Zotin Jezus që dhuroi jetën e Tij.

Martirët meritojnë nderim sepse janë dëshmitarë të vërtetë e dëshmia e tyre duhet të vihet re nga të gjithë sepse Atdheu ynë i dashur ka shumë

nevojë sot për dëshmitarë të tillë, për martirë që flijohen në jetën e përditshme për të mos u përlyer me logjikat e korrupsionit dhe mashtrimet e pushteteve që shfrytëzojnë të varfërit dhe e të çdo person njerëzor. Duhet të mësojmë nga martirët tanë të kemi forcën që t'i rezistojmë përfshirjes në klane e grupe që keqpërdorin të mirën e përbashkët e shkelin mbi ideale dhe dinjitetin e njeriut pa turp e pa burrëri. Martirët sot shkëlqejnë e na shpallin të vërtetën që dëshmuar me gjakun e tyre: Zoti Jezus është i gjallë dhe tek Ai është jeta dhe shpërblimi i jetës së pasosur.

Një falënderim që vjen prej zemrës do të doja t'ia drejtoj Parlamentit të Republikës i cili me anën e një rezolute solemne këto ditë dënoi fuqishëm vrasjet dhe persekutimin e regjimit komunist dhe njohu me bindje të plotë pafajsinë e Martirëve tanë. Përfitoj nga rasti për të falenderuar zonjën

Jozefina Topalli pasi ajo është nismëtarja në Kuvend e kësaj çeshtjeje.

Ënderuar Zoti President,

Në emrin e Kishës Katolike në Shqipëri dhe të familiarëve të Martirëve dua t'Ju falenderoj për këtë gjest kaq solemn që bëni për jetët dëshmitare të këtyre martirëve. Njëheri dua t'Ju siguroj se Kisha Katolike në Shqipëri vazhdon të shpallë në çdo cep të Vëndit atë të vërtetë që këto burra e gra shpallën. Martirët vdiqën se nuk pranuan të thonin para regjimit se e kemi mashtruar popullin dhe atë mësim e dëshmuar me jetën e tyre. Kisha ka qënë përherë e mot besnike e së vërtetës dhe e shpall kurdoherë atë duke qënë solidarë me më të varfërit ashtu si Nënë Tereza. Të gjithë kemi nevojë të përsosim jetën personale dhe shoqërore, por e vërteta që shpallet çdo ditë nga foltoret e kishave është ajo mbi të cilën këta martirë themeluan shpresën dhe jetën e tyre.

Gjergj Kastriotit, Nënë Terezës i bashkohen edhe 38 Martirët që i luten Zotit t'a bekojë Vëndin tonë. E ne i japim zë sot zërit të tyre: Rroftë Krishti Mbret! Rroftë Shqipëria!

REZOLUTË E KUVENDIT TË SHQIPËRISË

PËR DËNIMIN E KRIMEVE TË KOMUNIZMIT NDAJ KLERIT, SI DHE MIRËNJOHJEN E VEÇANTË PËR ROLIN DHE VEPRIMTARINË E KLERIKËVE NË MBROJTJEN E VLERAVE DEMOKRATIKE DHE TË DREJTAVE E LIRIVE THEMELORE TË NJERIUT

Duke u mbështetur në Rezolutën e Parlamentit European “Mbi ndërgjegjen europiane dhe totalitarizmin” (2009); Deklaratën e Pragës “Mbi ndërgjegjen europiane dhe komunizmin” (2008); Rezolutën 1096 (1996) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës “Masat për të çrrënjosur trashëgiminë e sistemeve totalitare komuniste”, si dhe Rezolutën 1481 (2006) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës “Domosdoshmëria për dënimin ndërkombëtar të krimeve të regjimeve totalitare komuniste”;

Në vijim të Rezolutës nr. 11, datë 30.10.2006, të Kuvendit të Shqipërisë, “Për dënimin e krimeve të kryera nga regjimi komunist në Shqipëri”;

Duke riafirmuar dënimin e plotë e pa ekuivok të regjimit diktatorial komunist të ngritur nga Enver Hoxha dhe bashkëpunëtorët e tij;

Duke shprehur mirënjohje të thellë për punën intelektuale dhe vlerat e jashtëzakonshme njerëzore që kanë treguar klerikët gjatë regjimit komunist në ruajtjen dhe promovimin e besimit fetar;

Duke konfirmuar dënimin me ashpërsi të dhunimit masiv të të drejtave të njeriut ndaj klerikëve shqiptarë, të kryer nga regjimi komunist i diktatorit Enver Hoxha, ku përfshihen edhe vrasjet (me dhe pa gjyq), vdekjet në kampet e përqendrimit, vdekjet nga uria, tortura, puna skllavëruese, terrori fizik e psikologjik;

Duke vlerësuar lart kontributin, vlerat dhe sakrificat e të gjithë klerikëve të vrarë apo persekutuar gjatë regjimit diktatorial të Enver Hoxhës dhe duke u përlur me mirënjohje të thellë ndaj veprës dhe punës së tyre për ruajtjen e besimit fetar dhe tolerancës fetare, e cila do t'i shërbejë ndërtimit të sotëm të një shoqërie të re dhe demokratike, që njeh dhe respekton lirinë e besimit

LUMNIMI I 38 MARTIRËVE

Vijim i fq. 9

dhe të drejtat e njeriut; Duke mbajtur në konsideratë se sipas dokumenteve ndërkombëtare dhe legjislacionit shqiptar aktet çnjerëzore të regjimit komunist ndaj klerikëve përbëjnë krime kundër njerëzimit dhe ndjekja e dënimi i tyre nuk parashkruhet;

Duke e vlerësuar se zhvillimet politike dhe shoqërore të 25 viteve të tranzicionit, pavarësisht nga përpjekjet që kanë bërë qeveritë shqiptare për njohjen dhe promovimin e vlerave të besimit fetar, në funksion të tolerancës fetare, nuk kanë qenë të plotë, pasi nuk është bërë nxjerrja e plotë e së vërtetës mbi krimet e komunizmit, edhe ndaj klerit në Shqipëri, si dhe dënimi i ideatorëve, organizatorëve dhe zbatuesve të drejtpërdrejtë në aparatën represiv të regjimit diktatorial, në zbatim edhe të parimeve dhe angazhimeve ndërkombëtare që i dënojnë krimet e komunizmit;

Duke qenë në dijeni të faktit se në 5 Nëntor 2016, në qytetin e Shkodrës, zhvillohet ceremonia e Lumturimit të disa klerikëve katolik shqiptarë të vrarë padrejtësisht nga regjimi komunist;

Deklaron me vendosmëri se:

Dënon fuqimisht diktatorin Enver Hoxha dhe regjimin totalitar komunist të instaluar prej tij së bashku me bashkëpunëtorët e vet, si dhe krimet e kryera prej tyre ndaj klerikëve shqiptarë.

Dënon fuqimisht vrasjen dhe persekutimin nga regjimi komunist dhe njeh me bindje të plotë pafajësinë e Dom Anton Zogaj, Imzot Frano Gjini, Marie Tuci, Atë Giovanni Fausti s.j., Vëlla Gjon Pantalia, Imzot Vinçenc Prennushi o.f.m., Imzot Jul Bonati, Dom Alfons Tracki, Atë Gjon Shllaku, Atë Karl Serreqi, Atë Mati Prendushi, Dom Jozef Maksen, Dom Lazër Shantoja, Dom Lekë Sirdani, Dom Luigj Prendushi, Atë Ciprian Nika, Atë Serafin Koda, Atë Gaspër Suma, Dom Anton Muza, Dom Dedë Maçaj, Dom Dedë Malaj, Mark Çuni, Atë Bernardin Pala, Atë Daniel Dajani, Gjelo Shllaku, Dom Mikel Beltoja, Dom Ndre Zadeja, Dom Mark Gjani, Dom Dedë Plani, Fran Mirakaj, Dom Ejëll Deda, Qerim Sadiku, Dom Jak Bushati, Papa Josif Mihali, Dom Marin Shkurti, Dom Ndoc Suma, Dom Pjetër Çuni, Dom Shtjefën Kurti, Hafiz Ali Korça, Hafiz Ibrahim Dalliu, Hafiz Ismet Dibra, Hafiz Sabri Koçi, Dede Reshat Bardhi, Haki Sharofi, Jonuz Bulaj, Vexhi Buharaja, Ismail Muçej, Haxhi Faik Sheh Qazim Hoxha, Hasan Tahsini, Baba Bedri i Brerimës, Baba Hajro Progonati, Hafiz Mustafa Varoshi, Hafiz Sherif Lëngu, Hafiz Esat Myftia, Hafiz Musa Dërguti, Hafiz Ali Kraja, Imam Liman Shabani, Imam Met Troci, Sheh

Ibrahim Karabunara, Sheh Myslim Luma, Baba Myrteza Kruja, Imam Ahmet Hyseni, Dervish Mehmet Verleni, Xhemal Naipi, Hafiz Sheuqet Boriçi, Hafiz Sabri Bushati, Molla Alush Zaganjori, Shejkh Hafiz Vehbi Sulejman Gavoçi, Selim Braja, Hafiz Bakalli, Hafiz Myrtja, Hafiz Muhamet Bekteshi, Sheh Ali Pazari, Sheh Reiz Sinani, Baba Ali Tomorri, Baba Qamil Gllava, Baba Shefqet Koshtani, Baba Bedri Cakrani, Dervish Ali Kocia, Dede Kamber Prishta, Baba Mehmet Zyka, Baba Islam Leskoviku, Baba Bajram Mahmutaj, Baba Islam Jangolli, Baba Ilmi Kurtesi, Dede Ahmet Myftari, Baba Sh. Cenametaj, Kryepiskop Visarioni Xhuvani, Kryehirësia e Tij Kristofor Kisi, Episkopi ndihmës i Apolonisë Irineu Banushi, Atë Gjergj Suli, Atë Aleksandër Lipe, Atë Dhimitër Leka, Atë Kostandin Bozdo, Atë Ligor Zografi, Atë Kosta Kole, Atë Thoma Verleni, Atë Kristo Raci, Atë Jorgji Kosta, Atë Simon Tonini, Atë Ilia Zoto, Atë Gjergj Dedi etj.

Vlerëson me mirënjohje të thellë veprën, punën intelektuale dhe vlerat e jashtëzakonshme njerëzore të klerikëve shqiptarë gjatë regjimit komunist për ruajtjen e besimit fetar dhe të tolerancës fetare, në funksion të ndërtimit për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm të një shoqërie të re dhe demokratike, që njeh dhe respekton lirinë e besimit dhe të drejtat e njeriut.

Vlerëson se klerikët që ishin viktimë e krimeve dhe persekutimeve të regjimit komunist, si dhe familjarët e tyre meritojnë rehabilitim, respekt dhe mirëkuptim për vuajtjen e tyre, si dhe mirënjohje për qëndresën e tyre ndaj sistemit më të egër diktatorial komunist në Europën Lindore.

Nxit Qeverinë që të rrisë fondet financiare dhe përpjekjet për zbulimin e krimeve të komunizmit ndaj klerikëve në Shqipëri, autorëve të këtyre krimeve, si dhe rehabilitimin e familjarëve të viktimave, në vazhden e përpjekjeve që ka bërë shteti shqiptar, në funksion të rehabilitimit dhe integritetit të tyre në jetën sociale, ekonomike e politike.

Nxit akademikët dhe historianët që të ndërmarrin veprimtari kërkimore-shkencore për përcaktimin dhe verifikimin objektiv të krimeve të komunizmit ndaj klerikëve në Shqipëri gjatë diktaturës komuniste, si dhe kërkon bërjen publike të të gjitha dokumenteve arkivore që dëshmojnë këto krime, nëpërmjet krijimit të mekanizmave të nevojshëm institucionalë, që do të bëjnë të mundur një evidentim real, bazuar mbi fakte dhe të dhëna konkrete të kohës.

ARQIPESHKVI NË XHAN DHE NË KIR PËR KREZMIME



Mes shumë angazhimesh ipeshkvi ynë Angelo Massafra, më 21 gusht gjeti kohën që të vinte në Pult për t'u ndarë krezmimin dy grupeve të të rinjve në fshatrat e Xhanit dhe Kirit.

Takimi me dy bashkësitë që i përzemërt: ipeshkvi dëftoi shpirtin e vet baritor duke u vënë në dispozicion për rrëfimet, dhe në homeli, si atë, i nxiti kandidatët për krezmim dhe të gjithë të pranishmit që të ndërgjegjësoheshin për faktin se jemi bij të Hyjit dhe dëshmitarë të Krishtit, duke i lënë ato gjëra që na nxisin në të keqen për ne dhe për të tjerët. Ipeshkvi pastaj bashkëndau një problem që e ka për zemër: martesat e vajzave tepër të reja, ose që nuk i njohin djemtë.

I nxitu prindërit të jenë shumë të kujdesshëm sepse janë të shumta divorcet që janë duke ndodhur. I nxitu fort besimtarët që të mos lejonin të mashtroheshin prej fitimit të lehtë duke mbjellur drogën, bartësen e vdekjes dhe të problemeve... dhe që kush e kishte mbjellë të ketë guximin ta shkulë, më mirë të jetojë në varfëri por me ndërgjegjen të qetë... Të rinjve që po merrnin krezmimin u tha: hapjani zemrën zërit të Zotit që vazhdon të thërrasë dhe ndiqeni atë.

Në fund të meshës bëri fotografi me secilin të sapokrezmuar dhe me të gjithë ata që dëshironin.

Kjo vizitë mund të ishte më e bukur dhe e gjatë nëse rrugët do të ishin më të përkueshme. Prekali është 38 km larg Kirit por duhet më se një orë për të shkuar atje. Duket më shumë si një lumë i tharë se si rrugë: shkëmbinj me thepa, gropa e gurë pa mbarim dhe asnjë mbrojtje në krahun e lumit Kir. Dy pjesët e rrugës që bashkojnë Kirin me Xhanin për 8 km dhe Planin për 10 km, ç'të themi për to?!... **Janë katastrofike.**

Nëse dëshirojmë që edhe këto zona të zhvillohen me anë të punës dhe që të nxitet turizmi, është absolutisht e nevojshme të mendohet për infrastrukturën: rrugët, shkollat dhe sigurinë fizike për çdo person.

Edhe ky popull ka dinjitetin e vet dhe bën pjesë në popullin shqiptar.

Në përfundim dua të kujtoj se më 19 qershor kremtuam Krezmimet në Ukbibaj dhe Shllak qendër (Log-Gegaj), dhe, me kërkesën e famullitarit, dom Gjovalin Simoni, shkuam për të ndihmuar në përgatitjen dhe në kremtimin e sakramentit.

Motër Sandra Bortolotto FKM



LAJME NGA DIOQEZA E SAPËS

EMËRTIMI I SHKOLLËS SË MESME TË BASHKUAR
TË VAU-DEJËS “IMZOT LUCJAN AVGUSTINI”

Këshilli Bashkiak Vau-Dejës, me vendim nr. 44 të datës 22.08.2016, i akordoi Shkollës së Mesme të Bashkuar të qytetit Vau-Dejës, titullin “Mons. Lucjan Avgustini”. Ceremonia e rastit u mbajt në Ipeshkvinë e Sapës, me datën 4 nëntor 2016, në praninë e shumë autoriteteve fetare, civile e shtetërore, si dhe familjarëve të tij. Në nderim të figurës së mons. Lucjan Avgustinit, ishte i pranishëm edhe kryetari i Komunës së vendlindjes së ipeshkvit tonë të dashur, Ferizaj, z. Muharrem Svarqa.

Administratori Dioqezan i Sapës, dom Simon Kulli në fjalën e hapjes ju uroi mirëseardhjen të gjithëve në këtë ceremoni në nder të ipeshkvit tonë të paharruar. Imzot Dodë Gjergji, ipeshkvi i Kosovës, e vlerësoi shumë këtë titull që shkolla e edukimit të brezave të rinj do të mbajë tani e tutje.

Në emër të Bashkisë, kryetari i saj z. Zef Hila e konsideroi këtë titull si një falenderim të vogël ndaj veprës së madhe dhe të paharruar të tij.

Në emër të familjes, vëlla i tij Lekë Avgustini, tha se për secilin nga ne, familjarët e tij, ky emërtim që Bashkia i jep Shkollës së Mesme në Vau-Dejës, është nder i madh, dhe krenari, tek prekim konkretisht, se si



mundi, djersa, sakrifica e vëllait tonë në shërbim të Zotit, Kishës dhe njeriut, vazhdon të lërë gjurmë, fryte paqeje dhe dashurie në këtë tokë shqiptare shumë të dashur nga ai.

Mons. Lucjan Avgustini, një pjesë të jetës së tij meshtarake prej 12 vitesh ia kushtoi shërbimit pastoral në Kishën Katedrale të Dioqezës së Shkodrës, duke mbuluar shumë role në këtë dioqezë. Kontributi i tij ka qenë shembullor duke dëshmuar kulturën e paqes dhe të dialogut, si të vetmet kritere të bashkëjetesës fetare. Pikërisht për këtë, me praninë e saj Kryetarja e Qarkut të Shkodrës, znj. Greta Bardeli, u dorëzoi familjarëve të mons. Avgustinit, titullin

më të lartë që ky Këshill mund të akordojë, **“Nderi i Qarkut” Shkodër (Post Mortem), me Motivacionin “Për ngjalljen e shpresës dhe të gëzimit tek personat, jeta e të cilëve përballet me vështirësi, vuajtje dhe mjerim; përmes kujdesit atëror ndaj tyre, duke zgjuar tek të gjithë ndërgjegjësimin ndaj dinjitetit të jetës, si burim që ndërton rrugën e qytetërimit të dashurisë dhe tharm i humanizmit shoqëror”.**

MESHË FALENDERIMI
PËR LUMNIMIN E MARTIRËVE SHQIPTARË

Pas kremtimit madhështor që u mbajt në Katedralen e Shën Shtjefnit në Shkodër me rastin e Lumturimit të Martirëve Shqiptarë, edhe dioqeza e Sapës ka kremtuar një meshë falenderimi duke i ngritur në altarin e të Lumturuarve këto Martirë që me shembullin e tyre heroik i qëndruan besnikë Krishtit deri në momentet e fundit të jetës.

Mesha u mbajt në Kishën e Martirëve Shqiptarë në Blinisht të Zadrimës, kryesuar nga martiri i gjallë i fesë, Kardinali shqiptar dom Ernest Troshani në bashkëkremtim me të gjithë meshtarët e Sapës. Për dioqezën tonë kësaj ngjarje iu shtua edhe gëzimi i ardhjes së eshtrave të martirëve të Sapës, don Ndoc Suma, don Luigj Prendushi, atë Giovanni Fausti, Atë Daniel Dajani në këtë kishë, pikërisht kjo Kishë e cila u frymëzua prej Shpirtit Shenjt në mënyrë profetike, në zemrën e të madhit Dom Antonio Sciarra, i cili këtë gëzim që po përjetojmë ne sot ai e parashikonte 20 vite më parë. Sot edhe ai bashkë me ipeshkvin tonë të

paharruar imzot Avgustinin, gëzojnë prej qiellit me Martirët tanë në Lumninë që i erdhi kësaj Kishë.

Si administrator i kësaj dioqeze, don Simon Kulli në fjalën e tij përshëndetëse falenderoi Zotin për ditën që ia dhuroi Shqipërisë. Gjithashtu, ai falenderoi edhe të gjithë të pranishmit për prezencën e tyre në Kishën e Martirëve tanë shqiptarë, Kishë kjo e cila tashmë përmes pranisë së martirëve do nxjerrë bekime të shumta për këtë famulli, për dioqezën por edhe për krejt popullin shqiptar që do e vizitojë në të ardhmen. Mes besimtarëve të shumtë, e pranishme ishte edhe mbesa e martirit dom Ndoc Suma, motra stigmatine Maria Kaleta, e cila u bë e njohur për mbarë botën me dëshminë e saj mbajtur para Atit të Shenjtë gjatë vizitës së tij në Shqipëri në shtator të vitit 2014. Përmes emocioneve të shumta edhe motër Maria shpreh falenderimin ndaj Zotit për këtë nderim që iu bë martirëve tanë.

INAUGURIMI I SHTËPISË SË LUTJES
“SHËN JOZEFI” KARMEL- NËNSHAT

Në praninë e Atit Gjeneral Karmelitan, atë Saverio Cannistrà, në prani të Arqipeshkvit të Shkodrës, imzot Angelo Massafra, Administratorit Dioqezan të Sapës dom Simon Kulli, meshtarë, motra dhe besimtarë të shumtë, kjo ceremoni u mbajt në ditën e Shën Terezës së Jezusit Fëmijë, (01.10.2016) në Kishën e Shën Mëhillit dhe të Familjes së Shenjtë, pranë kuvendit të Motrave Karmelitane.

Dom Simon Kulli tha “ndërsa uroi mirëseardhjen në këtë vend të shenjtë, ku për shekuj me radhë ka qenë ipeshkvia e Sapes, zemra e dioqezës sonë, kujtoi se, para se të ekzistonte kjo palestër e shpirtit, më së pari kishte lindur në zemrën e madhe të Imzot Lucjanit, i cili qe frymëzuar prej Zotit për ta ndërtuar një realitet të tillë që tashmë po merr jetë plotësisht tha ai. Në ngjashmëri me këtë palestër shpirtërore kemi edhe “Shtëpinë e Bamirësisë” në Vau-Dejës ku përjetohej më së miri veprat e mëshirshme. Këto dhe realitete të tjera në dioqezën tonë ishin dhe do mbeten vepra të Ipeshkvit tonë të dashur tha dom Simoni”.

Ati Gjeneral, atë Saverio gjatë përshëndetjes së tij, nuk ngurroi të shprehte me plot emocion gëzimin e rilindjes së këtij urdhri edhe në

Shqipëri, duke iu bashkuar kështu shërbimit në Kishën shqiptare. Ndërkohë që Imzot Massafra kujtoi se, “sot kemi mundësinë të shijojmë përshtypjet karmelitane falë ndihmës së dhënë prej pranisë së motrave karmelitane fillimisht, dhe prej vëllezërve që u janë bashkuar atyre në mënyrë që të ndihmojnë në pasurimin e tokës sonë me shpirtin profetik sipas mënyrës së Elisë”.

Me bekimin dhe prerjen e shiritit Shtëpia e Lutjes hapi dyert e saj për të mirëpritur të gjithë njerëzit vullnetmirë për tërheqje shpirtërore dhe takim me Zotin nëpërmjet lutjes, meditimit dhe soditjes.

Karmeli në Nënshat i ndërtuar në këtë vend me vlera historike, tashmë është kthyer në një qendër shpirtërore, e cila që prej 29 shtatorit 2003, do merrte jetë rishtas me ardhjen e Motrave Karmelitane. Kjo vepër shpirtërore u bë e mundur nga ish-ipeshkvi i Sapës, në atë kohë, imzot Dodë Gjergji.

Ndërsa në tetor të vitit 2013, me ftesë të imzot Lucjan Avgustinit u vendosën edhe Etërit Karmelitanë.

Violeta Marashi



facebook

HAPËSIRË MEDIATIKE

Regjistrohu në kanalin tone!

NgjarjetKishaKatolikeShkoderPult

Do të gjesh video të ngjarjeve
më të rëndësishme të dioqezës



Drejtues
Imzot Angelo Massafra

Redaksia
Arqipeshkvia

Lektore
Emanuela Marku Matija

Faqësia
Luigj Mila

Shtypshkronja
"Gjergj Fishta"
Lezhë